



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ENERGJISË
DHE INDUSTRIË

DREJTORIA E POLITIKAVE DHE ZHVILLIMIT TE MINIERAVE

Nr. **30/**
1

Tirane, date **4/5**/2016

Drejtuar: **ZNJ. TANA MARGARITI**
SHOQERIA "MARGARITI" SHPK
JERGUCAT

GJIROKASTËR

Për njoftim: **Z. DAEL DERVISHI, DREJTOR EKZEKUTIV**
AGJENCIA KOMBETARE E BURIMEVE NATYRORE
BULEVARDI "BAJRAM CURRI" BLLOKU "VASIL SHANTO"

TIRANE

Z.RRAPUSH TOLA, DREJTOR
REPARTI INSPEKTIM-SHPETIMIT TE MINIERAVE
RRUGA "LORD BAJRON", LAPRAKE

TIRANE

Lënda: Njoftim për fillim procedurash revokimi te lejes nr.1418 date 10.09.2009

E nderuara znj. Margariti,

Shoqëria "Margariti" shpk është zotëruese e lejes minerare te shfrytëzimit nr.1418 date 10.09.2009 për gurë gëlqeror, ne objektin "Peshkëpi" Gjirokastër.

Nga struktura përgjegjëse AKBN me shkresën nr.10882 date 30.12.2015, protokolluar ne Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë (MEI) me nr.30 date 05.01.2016, është propozuar revokimi i lejes minerare te shfrytëzimit nr.1418 date 10.09.2009 për gurë gëlqeror, ne objektin "Peshkëpi" Gjirokastër, për arsye se nuk është paguar garancia financiare për rehabilitimin e Mjedisit siç është përcaktuar ne nenin 31, pika 5 te ligjit nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë" te ndryshuar, për vitin 2015-2016.

Leja juaj është dhëne me Ligjin nr.7796 date 17.02.1994 "Minerar te Shqipërisë" te ndryshuar qe është shfuqizuar me ligjin nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë", te ndryshuar.

Sipas nenit 57 pika 2 dhe 3 te ligjit nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë", te ndryshuar, përcaktohet shtrirja e efekteve edhe për lejet e dhëna përpara hyrjes ne fuqi te këtij ligji.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare te Burimeve Natyrore për revokim është i mbështetur ne germën "ç" te pikës 1 te nenit 47 (neni qe përcakton shkeljet ligjore për te cilat një leje revokohet) te ligjit nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë", te ndryshuar.

Sa me sipër ne zbatim te nenit 48 te ligjit nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë", te ndryshuar, **ju njoftojmë fillimin e procedurave te revokimit te lejes minerare te shfrytëzimit shfrytëzimit nr.1418 date 10.09.2009 për gurë gëlqeror, ne objektin "Peshkëpi" Gjirokastrë, qe shoqëria juaj zotëron.**

Ju bëjmë me dije se pas një periudhe 30 ditore nga ky njoftim, do te merret vendimi për revokimin e lejes shfrytëzimit nr.1418 date 10.09.2009 për gurë gëlqeror, ne objektin "Peshkëpi" Gjirokastrë.

Ne zbatim te nenit 49 te ligjit nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë", te ndryshuar, duhet te rehabilitoni zonën e shfrytëzimit ne te cilën keni ushtruar aktivitet minerar.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin

MINISTRI

DAMIAN GJIKNURI

